



BASHKË

VALBON LIMANI

Me Gostivarin

n^o zemër



Zhvillimi urban dhe planifikimi hapësinor

Plani im për zhvillimin urban bazohet në një menaxhim të përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm të tokës ndërtimore, duke u përqendruar tek nevojat aktuale të komunitetit, por edhe duke parë përpëra drejt të ardhmes. Unë besoj se qyteti duhet të zhvillohet me vizion, rend dhe drejtësi, duke i dhënë fund praktikave të pakontrolluara që krijojnë kaos urban.

Plane urbanistike moderne

Do të hartojmë dhe zbatojmë plane urbanistike moderne dhe transparente, të cilat garantojnë një zhvillim të balancuar dhe të kontrolluar të qytetit. Çdo lagje do të ketë planin e vet, duke siguruar rrugë të rregulluara, hapësira publike dhe kushte të barabarta për të gjithë qytetarët. Me këtë qasje, i japim fund ndërtimeve pa leje dhe zhvillimit të çrregulluar.

Legalizimi dhe siguria ligjore

Një nga priorititetet e mia kryesore do të jetë përvizimi i procesit të legalizimit të objekteve ekzistuese pa leje. Kjo do të sjellë siguri ligjore për qytetarët, do të rrisë vlerën e pronës së tyre, dhe njëkohësisht do të krijojë mundësi për investime të reja në infrastrukturë atje ku deri më tani ka munguar. Legalizimi nuk do të mbetet vetëm në letra — ai do të shoqërohet me përmirësimë reale në infrastrukturën urbane.

Hapësirat publike dhe gjelbërimi urban

Hapësirat publike janë zemra e një qyteti. Unë synoj të rrisë ndjeshëm gjelbërimin urban përmes:

- Krijimit të parqeve të reja në çdo lagje,
- Mbjelljes së pemëve në bulevardet dhe rrugicat e qytetit,
- Investimeve në hapësira rekreative dhe sportive për të rinjtë dhe familjet.

Ky program do të sjellë një Gostivar më të gjelbër, më të pastër dhe më të shëndetshëm, ku qytetarët do të kenë hapësira për të pushuar, për të vrapuar, për të luajtur me fëmijët dhe për të shijuar jetën urbane në kushte më të mira.

Balans mes ndërtimit dhe natyrës

Unë besoj se zhvillimi nuk do të thotë betonim i qytetit. Përkundrazi, zhvillimi modern është ai që krijon një balancë harmonike mes ndërtimit dhe natyrës. Gostivari do të jetë shembull i një qyteti që rritet me kujdes për mjedisin, respekt për hapësirën publike dhe standarde të qarta ndërtimore.

Mesazhi politik:

"Një Gostivar me plan, me rend dhe me gjelbërim. Një qytet ku ndërtimi shkon paralel me natyrën dhe ku çdo hapësirë urbane është në shërbim të qytetarëve."

Infrastrukturë komunale dhe rrugore

Programi im për zhvillimin e infrastrukturës komunale është më ambiciozi ndonjëherë për Gostivar. Unë parashoh realizimin e mbi 100 projekteve të reja që do të ndryshojnë rrënjosht pamjen dhe funksionimin e qytetit. Këto investime do t'i japin Gostivarit një fytyrë moderne, funksionale dhe të gjelbër, duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e jetës së çdo qytetari.

Ky nuk është vetëm një plan ndërtimi, por një vizion për një Gostivar evropian: me rrugë të sigurta, ura moderne, hapësira të gjelbra, parkingje funksionale dhe një qendër qyteti që reflekton krenarinë tonë.

Ura e re mbi lumin Vardar

Ky është projekt simbol i zhvillimit. Një urë moderne me katër korsi për automjete, shtigje për bicikleta dhe trotuare të gjera për këmbësorë. Ajo do të bëhet ura e bashkimit të qytetit – që lidh lindjen me perëndimin, historinë me të ardhmen, njerëzit me njëri-tjetrin. Kjo urë nuk është vetëm beton dhe asfalt; ajo është simbol i unitetit dhe i zhvillimit ekonomik.

Hapja e bulevardit kryesor

Bulevardi kryesor do të transformohet në një arterie të re urbane. Do të pajiset me ndriçim modern, shtigje për këmbësorë e bicikleta, si dhe me hapësira të gjelbëruara që do e bëjnë atë një vend takimi, një qendër të gjallë sociale dhe kulturore për qytetarët. Ky bulevard do të jetë zemra e re e Gostivarit – plot jetë, plot energji, plot lëvizje.

Parkingu nëntokësor pranë Komunës

Në qindrën e qytetit, ku trafiku dhe parkimi janë bërë sfidë e përditshme, planifikoj të ndërtojmë një parking nëntokësor me 250 vende. I pajisur me teknologji moderne sigurie, ky parking do të ofrojë komoditet dhe qasje të shpejtë te objektet publike, tregtare dhe kulturore. Ai do të çlironë hapësirat publike nga kaosi i makinave, do të ulë ndotjen dhe zhurmën, dhe do të bëjë qindrën e qytetit më të pastër dhe të gjelbër.

Transformimi i qendrës së qytetit

Qendra e qytetit do të kthehet nga një hapësirë e mbingarkuar në një vend krenarie për çdo gostivaras. Projekti i ekipit tim parashikon ndërtimin e një nënkalimi nëntokësor për automjete dhe këmbësorë, si dhe një parking modern me 300 vende nën zemrën e qytetit.

Sipërfaqja e lartë do të shndërrohet në një plato moderne publike, me hapësira të gjelbra, kënde lojërash për fëmijë, zona rekreative, dhe kënde kulturore të hapura për koncerте, ekspozita dhe ngjarje të tjera. Qendra e Gostivarit do të jetë sheshi i qytetarëve, një hapësirë ku njerëzit takohen, shëtisin dhe jetojnë më mirë.

Projekte në çdo cep të Komunës

Unë nuk mendoj vetëm për qendrën e qytetit. Çdo lagje, çdo fshat, çdo cep i Komunës së Gostivarit do të përfshihet në këtë transformim.

- Rrugë të reja dhe rehabilitime në lagje e fshatra.
- Ura dhe kanalizime funksionale për siguri dhe higjenë.
- Ndriçim publik modern për çdo lagje.
- Infrastruktura sportive dhe rekreative në zonat rurale dhe urbane.

Ky është premtimi im: asnjë qytetar nuk do të mbetet jashtë zhvillimit. Nga qendra urbane deri në fshatin më të largët, Gostivari do të përjetojë një ndryshim të gjithanshëm.

Arsimi dhe edukimi

Arsimi është themeli i çdo shoqërie të suksesshme dhe garancia më e fortë për një të ardhme të ndritur të komunitetit tonë. Ne besojmë se çdo fëmijë i Gostivarit meriton kushte të denja, mësim cilësor dhe mbështetje për të arritur potencialin e tij. Për këtë arsy, përkushtimi ynë është i plotë në menaxhimin dhe përmirësimin e institucioneve arsimore, duke siguruar një ambient të sigurt, modern dhe motivues si për nxënësit ashtu edhe për stafin arsimor.

Menaxhimi dhe përmirësimi i kushteve në institucionet arsimore

Në vitin e fundit ekipi im ka dëshmuar se ndryshimi është i mundur: rinnovimi i fasadave, ndërrimi i dritat e reave dhe dyerive, përmirësimi i ngrohjes dhe izolimit, si dhe përmirësimi i sistemeve elektrike dhe sanitare në shkollat fillore të komunës. Një shembull i qartë është shkolla fillore në fshatin Llakavicë, ku pas renovimit, nxënësit dhe mësuesit gjelqjnë kushte moderne dhe të sigurta. Ky është vetëm fillimi — renovime të ngjashme do të ndodhin në çdo lagje dhe fshat të Gostivarit, që asnjë nxënës të mos mbetet pas.

Në çerdhet komunale do të ndërtohen ambiente të reja dhe do të rinnovohen ato ekzistuese. Ato do të pajisen me kushtet më bashkëkohore për kujdes dhe edukim parashkollar, duke u ofruar prindërve qetësi dhe fëmijëve një fillim të sigurt drejt zhvillimit të hershëm.

Investime strukturore dhe pajisje edukative

Edukimi i shekullit XXI kërkon teknologji të shekullit XXI. Planifikoj furnizimin e shkollave me:

- Kompjuterë modernë dhe pajisje digitale për çdo klasë.
- Materiale didaktike bashkëkohore që ndihmojnë mësim efektiv.
- Infrastrukturë teknologjike të avancuar, për t'i përgatitur nxënësit pëtregun global dhe sfidat e së ardhmes.

Çdo shkollë në Gostivar do të ketë klasa digitale që nuk do të dallojnë nga standartet e vendeve evropiane.

Rritja e cilësisë së arsimit në nivel lokal

Arsimi nuk matet vetëm me ndërtesa, por edhe me cilësinë e mësimit. Për këtë do të:

- Organizojmë trajnime të vazhdueshme për mësuesit dhe drejtuesit e shkollave, duke sjellë metoda inovative të mësimdhënies.
- Promovojmë edukim gjithëpërfshirës, ku çdo fëmijë, pavarësisht prejardhjes apo aftësive, të ketë shanse të barabarta.
- Nxismim përfshirjen e nxënësve në aktivitete shkencore, kulturore dhe sportive, duke i zhvilluar në mënyrë të plotë si individë.
- Krijojmë ura bashkëpunimi me shkollat profesionale, universitetet dhe bizneset lokale, për të siguruar praktikë profesionale dhe punësim të shpejtë për të rinjtë.

Bashkëpunim me institucionet dhe organizatat

Zotohem se do të ndërtoj partneritete të forta me:

- Ministrinë e Arsimit për mbështetje në projekte madhore,
- Organizatat joqeveritare për zhvillimin e programeve sociale dhe edukative,
- Komunitetin e biznesit dhe donatorët për pajisje dhe projekte të avancuara,
- Partnerë ndërkombëtarë për shkëmbim përvojash, trajnime dhe projekte evropiane që rrisin kapacitetet e nxënësve dhe mësimdhënësve.

Ky bashkëpunim do të sjellë një fryshtë tē re në arsim dhe do ta bëjë Gostivarin pjesë tē një rrjeti modern edukativ ndërkombëtar.

Përfundimisht

Investimi në arsimin e fëmijëve tanë është investimi më i madh që mund tē bëjmë për tē ardhmen e Gostivarit. Me shkolla bashkëkohore, me mësimdhënës tē trajnuar dhe me nxënës tē mbështetur për tē arritur potencialin e tyre, ne do tē ndërtojmë një komunitet tē edukuar, inovativ dhe prosperues.

Mesazhi politik

"Shkolla moderne, mësues tē përkushtuar, nxënës me ëndrra tē mëdha. Gostivari i së ardhmes fillon në bankat e shkollës."

Kultura, rinia dhe sporti

Kultura, rinia dhe sporti janë shtyllat e shpirtit të një qyteti modern. Ato krijojnë identitet, bashkojnë brezat dhe ndërtojnë ura midis traditës dhe të ardhmes. Për këtë arsy, programi im i kushton rëndësi të veçantë zhvillimit të një Gostivari dinamik, kreativ dhe sportiv, ku çdo qytetar gjen hapësirë për të shprehur veten, për t'u zhvilluar dhe për t'u ndjerë krenar me qytetin e tij.

Ngjarjet kulturore dhe trashëgimia

Do të mbështes dhe zgjeroj organizimin e festivaleve tradicionale dhe moderne, ngjarjeve artistike dhe aktiviteteve edukative që e pasurojnë jetën e komunitetit.

- Festivalet e kulturës dhe artit do të marrin mbështetje institucionale dhe financiare.
- Traditat e Gostivarit do të promovohen në mënyrë moderne, duke u bërë pjesë e turizmit kulturor.
- Do të krijoj një kalendar kulturor vjetor, me aktivitete të shpërndara në të gjitha lagjet dhe fshatrat e komunës, që kultura të mos mbetet vetëm në qendër, por të ndihet në çdo cep të Gostivarit.

Menaxhimi dhe mirëmbajtja e objekteve kulturore e sportive

Objektet ekzistuese kulturore dhe sportive do të përmirësohen dhe mirëmbahen në mënyrë sistematike.

- Në Gostivar ekziston vetëm një sallë sportive funksionale, ndërsa pjesa tjetër e lojërave dhe terreneve sportive janë në ambient të hapur. Për këtë arsy, prioritet do të jetë modernizimi i sallës ekzistuese, duke e pajisur me kushte bashkëkohore për zhvillimin e teatrit, ekspositave, aktiviteteve rimore dhe sporteve të myllura. Në të njëjtën kohë, do të investojmë në përmirësimin e terreneve të hapura sportive për t'i bërë më funksionale, më të sigurta dhe më të qasshme për të gjithë qytetarët.

- Gjithashtu, do të ndërtojmë terrene të reja sportive dhe rekreative në lagje dhe fshatra, duke siguruar që secili komunitet të ketë hapësira të përshtatshme për sport dhe rekreacion. Këto hapësira do të jenë të pajisura sipas standardeve bashkëkohore dhe do të shërbejnë si vende për shëndet, argëtim dhe bashkim social për të rinjtë, familjet dhe qytetarët e të gjitha moshave.
- Do të zbatoj një politikë të qartë: asnje hapësirë kulturore apo sportive nuk do të lihet në harresë.

Mbështetja e rinisë dhe angazhimit qytetar

Rinia është energji dhe shpresë. Do të përkrahi programe që i motivojnë të rinjtë të jenë pjesë aktive e shoqërisë dhe vendimmarrjes:

- Do të hapim qendra rimore multifunksionale ku të rinjtë mund të zhvillojnë aktivitete kulturore, artistike dhe edukative.
- Do të ofroj grante të vogla për projekte rimore dhe iniciativat e studentëve.
- Do të promovojmë aktivizmin qytetar dhe përfshirjen e të rinjve në proceset e vendimmarrjes komunale.
- Do të ndërtoj ura bashkëpunimi mes rinisë, universiteteve, biznesit lokal dhe organizatave ndërkombëtare.

Sporti dhe rekreacioni për të gjithë

Sporti është shëndet, disiplinë dhe bashkim social. Do të investoj në ndërtimin e hapësirave sportive moderne dhe në promovimin e aktiviteteve fizike për të gjithë qytetarët:

- Terrene të reja sportive në lagje dhe fshatra, të pajisura sipas standardeve bashkëkohore.
- Hapësira për rekreacion dhe parqe ku familjet dhe fëmijët mund të shijojnë kohën e lirë.
- Mbështetje për klubet sportive lokale dhe krijimi i mundësive për fëmijët dhe të rinjtë që duan të ndjekin sportin në mënyrë profesionale.

Pishina e re me standarde evropiane

Një nga projektet madhore që do ta shndërrojë Gostivarin në qendër sportive rajonale është ndërtimi i një pishine moderne me standarde evropiane.

- Do të jetë e hapur për qytetarët, nxënësit dhe sportistët, si vend stërvitjeje, rekreacioni dhe pushimi.
- Do të organizohen gara sportive dhe aktivitete ujore, duke rritur profilin e qytetit dhe duke sjellë vizitorë nga rajoni.
- Pishina do të jetë një simbol i Gostivarit aktiv, modern dhe sportiv.

Përfundimisht

Kultura, rinia dhe sporti nuk do të mbeten më në periferi të politikave komunale, por do të jenë forca lëvizëse të zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe edukativ. Me aktivitete kulturore gjithëvjetore, me të rinj aktivë në qendrat rimore, me terrene dhe pishinë moderne, Gostivari do të bëhet një qytet i gjallë, plot jetë dhe plot mundësi.

Mesazhi politik

"Një Gostivar me kulturë të gjallë, me rini aktive dhe me sport modern. Një qytet ku çdo qytetar ka hapësirë për të krijuar, për të lëvizur dhe për të ëndërruar."

Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmi

Zhvillimi ekonomik është shtylla kryesore e mirëqenies së qytetarëve dhe një faktor kyç për të ardhmen e qëndrueshme të komunës së Gostivarit. Ky programi është i fokusuar në krijimin e një ekonomie të fortë, dinamike dhe inovative, ku çdo qytetar ka mundësi për punësim dhe zhvillim profesional, ndërsa bizneset vendore gëzojnë mbështetje të plotë për të lulëzuar.

Përkuqja dhe promovimi i bizneseve lokale

Bizneset e vogla dhe të mesme janë zemra e ekonomisë sonë. Ne do të krijojmë:

- Qendra mbështetëse për bizneset ku sipërmarrësit marrin shërbime për regjistrim, këshilla ligjore dhe financiare, trajnime dhe mentorim.
- Lehtësime administrative për procedurat e regjistrimit dhe licencimit, që të kursetet koha dhe të ulen kostot për bizneset.
- Mbështetje financiare dhe grante për biznese inovative, bujqësi të qëndrueshme, start-up teknologjike dhe artizanat lokal.
- Tregje të organizuara për prodhuesit vendorë, ku produktet e Gostivarit (bujqësore, artizanale, ushqimore) do të kenë hapësirë të denjë për shitje dhe promovim.

Kjo do të krijojë një ekosistem ekonomik të fuqishëm ku kapitali i qytetit mbetet brenda komunitetit dhe kthehet në përfitime për të gjithë.

Politika për zhvillim ekonomik lokal

Do të hartojmë politika afatgjata për një Gostivar ekonomikisht të qëndrueshëm dhe konkurrues, duke përfshirë:

- Investime në infrastrukturë industriale (zona industriale të pajisura me rrugë, energji, ujë e internet).
- Mbështetje për përdorimin e teknologjive të reja dhe digitalizimin e bizneseve.
- Bashkëpunim publik-privat për projekte zhvillimore dhe inovative.
- Platforma të rregullta dialogu me bizneset lokale për të përcaktuar priorititetet dhe për të adresuar sfidat reale.

Nxitja e investimeve vendore dhe të huaja

Gostivari do të promovohet si një destinacion i besueshëm për investitorët. Përmes bashkëpunimit me institucionet qendrore dhe ndërkombëtare, do të sigurojmë:

- Infrastrukturë moderne në shërbim të investitorëve.
- Kushte fiskale të favorshme dhe transparencë të plotë në procedura.
- Promovim aktiv të Gostivarit në panaire dhe forume ndërkombëtare si qendër e mundësive ekonomike në rajon.
- Tërheqje investimesh në sektorët strategjikë: agro-përpuni, turizmi, shërbimet digitale, energjia e pastër dhe industria e lehtë.

Kjo do të gjenerojë vende të reja pune, rritje të gjen eroje ardhurave dhe zhvillim ekonomik afatgjatë.

Promovimi i turizmit dhe shfrytëzimi i potencialeve

Gostivari është një thesar i pazbuluar turistik. Me natyrën e mrekulueshme, kulturën multietnike dhe trashëgiminë historike, ne do të:

- Investojmë në infrastrukturë turistike: rrugë të përmirësuara drejt zonave turistike, sinjalistikë moderne dhe qendra informuese.
- Zhvillojmë turizmin malor dhe rekreativ në Sharr dhe Korab, duke ofruar shtigje të rregulluara, guidë turistike dhe objekte akomoduese të vogla.
- Promovojmë turizmin kulturor dhe gastronomik, duke kthyer festivalet dhe traditat lokale në atraksione që tërheqin vizitorë nga rajoni e më gjérë.
- Organizojmë ngjarje ndërkombëtare (festivale, panaire, gara sportive) që e vendosin Gostivarin në hartën e turizmit rajonal.

Turizmi do të kthehet në një burim të rëndësishëm të ekonomisë lokale, duke krijuar punësim të ri dhe duke rritur imazhin pozitiv të qytetit.

Përbledhje

Synoj ta kthej Gostivarin në një qendër ekonomike dinamike dhe një destinacion turistik tërheqës. Me biznese vendore të fuqizuara, investime të reja dhe promovim të turizmit, Gostivari do të bëhet një qytet ku punësimi, inovacioni dhe mirëqenia sociale ecin dorë për dore.

Mbrojtja dhe menaxhimi i ambientit jetësor

Një mjeshterës i pastër është themeli i një shoqërie të shëndetshme dhe një e ardhme e sigurt përfmijët tanë. Gostivari përballet me sfida serioze në cilësinë e ajrit, ujit, hapësirave të gjelbra dhe ndotjen urbane. Prandaj, programi ynë është i orientuar drejt politikave afatgjata përmes mbrojtjen e natyrës dhe adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, duke vendlodhi komunitetin dhe natyrën në qendër të çdo vendimmarrjeje.

Politikat përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe mjeshterës

- Kontroll rigoroz të burimeve urbane dhe industriale të ndotjes.
- Monitorim në kohë reale me matës modernë përmirësimin e cilësinë e ajrit në disa pika të qytetit.
- Fuqizim i efikasitetit energjetik në ndërtesat publike dhe projektet e reja, duke përdorur standarde të gjelbra dhe teknologji të pastra.
- Partneritete me organizata mjeshterësore përmirësimin e cilësisë së ajrit, duke zbatuar projekte inovative që sjellin standardet e BE-së në Gostivar.

Projekte përmirësimi i cilësisë së ajrit

- Krijimi i parqeve të reja urbane dhe shesheve publike në çdo lagje e fshat.
- Mbjellja masive e pemëve – mijëra fidanë çdo vit përmirësimin e cilësisë së ajrit, duke përmirësuar klimën urbane.
- Korridore të gjelbra që lidhin zonat urbane me ato rurale, duke krijuar një rrjet të integruar natyror.
- Kënde të posaçme përfmijë, të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuar, përmirësimin e cilësisë së ajrit.
- Mjetet moderne përmirësimin e cilësisë së ajrit, duke dedikuara përmirësimin e cilësisë së ajrit.
- Aksione periodike të pastrimit në bashkëpunim me shkollat, OJQ-të dhe shoqatat qytetare.

Edukimi ambiental dhe vetëdija qytetare

Një qytet i pastër fillon me qytetarë të vetëdijshëm. Për këtë do të:

- Promovojmë edukimin ambiental në programet shkollore dhe qendrat rinore.
- Organizojmë fushata të vazhdueshme mbi riciklimin, kursimin e ujit dhe energjisë, si dhe përgjegjësinë kolektive ndaj natyrës.
- Krijojmë programe praktike si "Ditët e pastrimit", "Të rintjtë për natyrën", punëtori mbi ekonominë qarkuese dhe inovacionin e gjelbër.
- Përfshijmë buxhetimin pjesëmarrës në vendimmarjet mjedisore, që qytetarët të ndihen pjesë e drejtpërdrejtë e ndryshimit.

Menaxhimi i rreziqeve natyrore dhe ndryshimet klimatike

Gostivari nuk mund të mbetet i papërgatitur ndaj fatkeqësive natyrore. Programi ynë përfshin:

- Plan komunal për menaxhimin e rreziqeve nga përmbytjet, rrëshqitjet e dheut, zjarret në pyje dhe stuhitë.
- Sisteme paralajmërimi të hershëm për qytetarët.
- Ekipë emergjente të trajnuara dhe të pajisura për reagim të shpejtë.
- Investime në infrastrukturë mbrojtëse (kanale, brigje, shërbime zjarrfikëse moderne).

Mesazhi politik:

"Mjedisi është pasuria më e madhe e Gostivarit. Ne do të ndërtojmë një qytet më të pastër, më të gjelbër dhe më rezistent ndaj sfidave klimatike – një vend ku natyra dhe zhvillimi ecin bashkë."

Transparenca, Llogaridhënia dhe Demokracia Lokale

Qeverisja e mirë fillon me besimin dhe përfshirjen aktive të qytetarëve në çdo proces publik. Qytetarët janë themeli i pushtetit lokal, prandaj transparenca, llogaridhënia dhe demokracia pjesëmarrëse do të jenë shtylla themelore të qeverisjes sonë në Komunën e Gostivarit.

Përmirësimi i transparencës dhe qasjes në dokumentet publike

- Do të digjitzojmë plotësisht shërbimet komunale: qytetarët do të mund të porosisin online dokumente administrative, të konsultojnë planet urbanistike, projektet dhe tenderët, si dhe të shkarkojnë vendimet e Këshillit Komunal.
- Do të krijojmë një arkiv publike digitale ku çdo qytetar ka qasje në dokumente pa burokraci dhe në tri gjuhët zyrtare (shqip, maqedonisht, turqisht).
- Pranë Komunës, do të funksionojë një sallë e hapur e transparencës, ku do të ekspozohen makete, projekt-dokumente dhe plane urbane që prekin të ardhmen e qytetit.
- Buxheti komunal dhe shpenzimet publike do të publikohen në mënyrë periodike dhe të qasshme, duke ndërtuar besim dhe ndershmëri institucionale.

Forcimi i mekanizmave për pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje

- Demokracia nuk është vetëm një votë çdo katër vjet, por një proces i vazhdueshëm. Do të nxism forume publike, referendumë lokale, peticione elektronike dhe pyetje të hapura për çështje kyçë.
- Do të zbatojmë buxhetimin pjesëmarrës: çdo vit, një pjesë e buxhetit do të dedikohet për projekte të propozuara, votuara dhe monitoruara nga vetë qytetarët.
- Do të formohen këshilla qytetare tematike (urbanizëm, ambient, rinia, arsimi, barazia gjinore, grupet e ndjeshme), të cilat do të jepin rekomanime për çdo vendim të madh të komunës.

- Të rinjtë dhe grupet e marginalizuara do të kenë hapësira të posaçme për pjesëmarrje, përmes debateve, trajnimeve dhe platformave digjitale.

Përgjegjësia dhe llogaridhënia e administratës komunale

- Administrata komunale do të funksionojë mbi parimet e profesionalizmit, barazisë dhe shërbimit të ndershëm ndaj çdo qytetari, pa dallim etnie, religjioni apo bindjeje politike.
- Do të publikohet një raport tremujor i punës së komunës, ku do të pasqyrohen projektet e realizuara, shpenzimet dhe planet e ardhshme. Ky raport do të prezantohet publikisht në takime të hapura me qytetarët.
- Do të rritet efikasiteti i komunikimit përmes linjave telefonike dhe platformave online për raportimin e problemeve të përditshme (ndotje, defekte në rrjet, ankesat e qytetarëve).
- Do të forcohen bordet këshilluese në shërbimet publike kryesore (ujësjellës, mbeturina, transport), duke i dhënë qytetarëve rol në planifikim dhe kontroll.
- Do të krijohet një kulturë e re e shërbimit publik: çdo nëpunës komunal do të trajnohet në etikë, transparencë dhe shërbim qytetar.

Buxheti pjesëmarrës dhe kontrolli publik

- Një përqindje e buxhetit do të ndahet për projektet që qytetarët zgjedhin vetë: ndërtim parku, ndriçim rruge, infrastrukturë shkollore apo aktivitete sociale.
- Çdo fazë e procesit – nga ideja, analiza, votimi deri te realizimi – do të jetë e hapur dhe e monitoruar nga qytetarët.
- Në këtë mënyrë, qytetarët nuk do të jenë vetëm shikues, por aktorë aktivë të zhvillimit të qytetit të tyre.

Mesazhi politik:

"Transparencë në çdo vendim, llogaridhënie në çdo veprim, demokraci në çdo hap. Gostivari do të bëhet shembull i qeverisjes së hapur dhe pjesëmarrëse."

VALBON LIMANI

